



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj, administruar pranë Bashkisë Shkodër Nr. Prot. 6322 datë 19.03.2025, bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, pas shqyrtimit të kërkesës tuaj e cila ishte në përputhje me kërkesat e ligjit të specifikuar, ju informojmë si më poshte:

Buxheti i planifikuar në Bashkinë Shkodër për rininë, për periudhën janar-dhjetor 2024 është 2,087,000 lekë, duke përfshirë shpenzimet për funksionimin e Qendrës Rinore „Atelie“ dhe realizimin e aktiviteteve rinore. Kjo shumë përbën 0.79% të buxhetit total të Bashkisë Shkodër, i cili është 2,651,609,000 lekë.

Në lidhje me strukturën e stafit, numri total i punonjësve të Bashkisë Shkodër për vitin 2024 është 288, ndërsa të rinjtë (18-29 vjeç) të punësuar në Bashki janë gjithsej 50, nga të cilët 35 janë femra dhe 15 janë meshkuj. Bashkia Shkodër nuk ka të rinj (18-29 vjeç) që mbajnë pozita drejtuese ose vendimmarrëse.

Për sa i përket politikave rinore, Bashkia Shkodër është në proces të hartimit të "Planit Vendor të Veprimit për Rininë", në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029. Ky plan ka për qëllim përfshirjen e të rinjve në vendimmarrje, punësim, edukim, teknologji dhe inovacion, si dhe promovimin e aktiviteteve artistike, sportive dhe vullnetarizmin. Bashkia Shkodër ka Sektorin e Rinisë brenda Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik, sektor i cili ka 2 punonjës dhe është funksional prej 1 viti.

Bashkia Shkodër disponon gjithashtu një Qendër Rinore Publike të quajtur "Atelie", e cila ofron mundësi për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme që lidhen me arsimin, punësimin dhe sipërmarrjen rinore, trashëgiminë kulturore, artin, sportin, teatrin, muzikën, vullnetarizmin, çështjet sociale dhe shëndetësore, duke përdorur metodologjinë e edukimit jo-formal. Aktivitetet në këtë qendër organizohen në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Qendra Rinore "Atelie" është gjithashtu pjesë e rrjetit të 12 Qendrave Komunitare "Për Familje", të cilat ofrojnë një gamë shërbimesh, përfshirë informim, orientim dhe këshillim për të rinjtë, shërbime mbështetëse psiko-sociale, ndërhyrje të hershme për fëmijët dhe të rinjtë, si dhe mbështetje për fëmijët, të rinjtë dhe familjet në formën e fuqizimit ekonomik dhe programeve të prindërimit.

Përveç kësaj, Bashkia Shkodër ka ngritur Këshillin Vendor Rinor (KVR), i cili është një organ këshillimor që funksionon pranë kryetarit të bashkisë dhe që këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për politikën dhe planet rinore, vlerëson situatën e të rinjve dhe propozon përmirësime të politikave rinore. Ky këshill ka ndjekur një plan veprimi të orientuar drejt angazhimit aktiv të të rinjve dhe bashkëpunimit me institucionet lokale për të ndikuar në politikat rinore. Gjatë vitit

2024, janë realizuar një sërë aktivitete dhe nismash me impakt të drejtpërdrejtë në komunitetin rinor të Shkodrës, të cilat përfshijnë hapjen e thirrjes për krijimin e një skeme granti për bizneset eko-inovative për të rinjtë, iniciativën për Kartën e Studentit dhe Mensen Studentore në Universitetin e Shkodrës, aktivitete për pastrimin e mjedisit dhe sensibilizimin për mbrojtjen e natyrës, si dhe organizimin e festivalit rinor "Youth Wave". Po ashtu, janë realizuar evente për mbështetje të fëmijëve në nevojë dhe takime për përmirësimin e politikave rinore në qytet.

Për të rritur ndikimin dhe efektivitetin e Këshillit Vendor të Rinisë Shkodër, është e nevojshme mbështetje financiare më të qëndrueshme për zhvillimin e projekteve afatgjata dhe për zgjerimin e mundësive për të rinjtë. Gjithashtu, duhet të zhvillohet një strategji e qartë bashkëpunimi me sektorin privat dhe organizatat rinore për të krijuar mundësi punësimi dhe praktikash për të rinjtë, si dhe të rritet angazhimi i të rinjve në politikëbërjen vendore, duke forcuar rolin e KVR-së si një urë lidhëse midis të rinjve dhe institucioneve.

Sipas pikës 2 të nenit 10 të ligjit nr. 75/2019 "Për rininë", Këshilli Vendor Rinor përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët 2 janë femra dhe 3 janë meshkuj, ndërsa njëri prej anëtarëve përfaqëson personat me aftësi të kufizuara.

Bashkia Shkodër ka ndërmarrë një punë të vazhdueshme për të krijuar partneritete me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me institucione të ndryshme për zhvillimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit në fushën e rinisë. Ndër organizatat me të cilat Bashkia Shkodër bashkëpunon janë "Save the Children", "UNICEF", "YEA! – Young Entrepreneurs Albania" dhe "Europe Goes Local". Këto organizata ofrojnë mbështetje të ndryshme për zhvillimin e aftësive rinore, krijimin e mundësive për sipërmarrësit e rinj, si dhe mbështetje për përdorimin e teknologjisë. Po ashtu, Bashkia ka krijuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione lokale si Teatri i qytetit "Migjeni", Qendra Kulturore "Pjetër Gaci" dhe Biblioteka "Marin Barleti".

Mjetet e komunikimit që Bashkia Shkodër përdor për të përcjellur informacionin janë faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër, faqja në Facebook dhe Instagram, ku publikohen lajme dhe informacione lidhur me aktivitetet dhe zhvillimet në bashki.

Për vitin 2024, numri total i personave që janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror është 29, ku 26 janë femra dhe 3 janë meshkuj. Ndërkohë, nuk ka një numër të përcaktuar për të rinjtë (15-29 vjeç) që janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2024.

Përsa i përket pyetjeve tuaja nr.15, 16, 17 & 18 do gjeni përgjigjet në dokumentin bashkangjitur.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

	Skema e Pikezimit							
	Nr. i Familjeve	Nr. total I antareve	F	M	Mosha 15-29	F	M	Nr. I familjeve
1-Nj.Ad. Qendër	196	574	298	276	158	68	74	132
2-Nj.Ad.Velipojë	61	271	131	140	65	31	34	3
3-Nj.Ad.Dajç	10	46	26	20	15	7	8	4
4-Nj.Ad.Bërdicë	119	481	254	227	208	115	93	5
5-Nj.Ad.A.Malit	53	199	98	101	30	20	10	5
6-Nj.Ad.Gur i Zi	149	590	308	282	80	47	33	11
7-Nj.Ad.Rrethina	348	1426	728	698	540	278	262	20
8-Nj.Ad.Postribë	312	1284	672	612	373	192	183	5
9-Nj.Ad.Pult	149	651	332	319	285	146	139	6
10-Nj.Ad.Shalë	98	405	207	198	242	129	113	10
11-Nj.Ad.Shosh	57	242	129	113	101	61	50	2
Totali	1552	6169	3183	2986	2097	1094	999	203

V.O- Te dhenat e mesiperme I jane referuar muajit dhjetor te vitit 202

Skema 6% Fondi I Kushtezuar									
Nr. Total I anetareve	F	M	Mosha 15-29	F	M	Paaftesi	F	M	Mosha 15-29
226	119	107	19	12	7	1210	488	722	177
8	7	1	4	4	0	73	28	45	15
6	4	2	0	0	0	46	23	23	4
10	6	4	1	1		124	52	72	7
9	6	3	0	0	0	79	30	49	11
21	14	7	2	0	2	168	81	87	12
38	24	14	8	5	3	413	197	216	54
6	4	2	0	0		152	69	83	28
9	6	3	0	0	0	62	22	40	17
17	12	5	0	0	0	47	21	26	13
3	2	1	0	0	0	19	9	10	1
353	204	149	34	22	12	2393	1020	1373	339

4 dhe jane pa kujdestaret e kategorise se PAK.

PAK

F	M	Verberi	F	M	Mosha 15-29	F	M	Para/Tetraplegji	F
82	95	266	128	138	7	2	5	142	76
5	10	18	4	14	3	1	2	15	6
2	2	8	2	6	0	0	0	10	3
5	2	20	12	8	3	2	1	9	7
3	8	6	4	2	0	0	0	5	4
7	5	28	17	11	0	0	0	16	5
21	33	52	29	23	0	0	0	38	17
13	15	23	8	15	1	0	1	12	7
8	9	2	1	1	0	0	0	2	0
7	6	8	3	5	0	0	0	4	
1	0	3	2	1	0	0	0	1	1
154	185	434	210	224	14	5	9	254	126

M	Mosha 15-29	F	M
66	13	9	4
9	4	1	3
7	0	0	0
2	1	1	0
1	1	0	1
11	1	0	1
21	10	4	6
5	1	1	0
2	0	0	0
4	1	0	1
0	0	0	0
128	32	16	16